



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.172 dt.31.08.2000

**MBI
SHQYRTIMIN E ANKESAVË PËR DHENIE LEJE NDERTIMI
NGA K.RR.T.**

Këshilli Bashkak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.31.08.2000, pasi shqyrtoi ankesat e disa qytetarëve dhe shkresat nga institucionet, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, ndryshuar me Nr.8068, dt.15.02.1996 dhe Nr.8138, dt.31.07.1996, neni.14. pika.12, dhe 16, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, si dhe ligjin Nr.8405, dt.14.09.1998 “Për urbanistikën” dhe pasi dëgjuan propozimin e komisionit të zhvillimit urban dhe ndërtimeve;

V E N D O S I

1. Për shkresën Nr.1490, dt.10.08.2000 të ardhur nga Prefektura, për rishqyrtim të vendimit të K.RR.T. në favor të Z. Jani Cekici. Të miratohet vendimi i K.RR.T. sepse, leja e ndërtimit është në përputhje me ligjin.
2. Për shkresën Nr.1435, dt.04.08.2000 nga Prefektura, për rishqyrtim të vendimit të K.RR.T. , për shtesë ballore në pjesën e prapme të pall.Nr.1 në Rr.”Ded Gjon Luli”, për shkelje të ligjit Nr.62 të ligjit për urbanistikën (Nr.8405).Meqënëse është ndryshuar projekti duke eliminuar volumin që prek kafazin e

shkallëve, leja e dhënë nga K.RR.T. është e rregullt, në përputhje me ligjin.

3. Për shkresën Nr.1432, dt..08.2000 nga Prefektura, për rishqyrtim të vendimit të K.RR.T. e dhënë në favor të znj. Lindita Tepelena për objekt 2 kat në Rr.”S. Frashëri”. Të miratohet leja e dhënë si e rregullt sepse është dhënë në pronë private dhe jo publike.
4. Për shkresën Nr.1410, dt.04.08.2000 nga Prefektura, për rishqyrtim të vendimit të K.RR.T.

1.Për zgjidhje konflikti i krijuar ndërmjet legatës Austriake dhe qytetarëve Stefan Kaçinari. Të miratohet leja e dhënë nga K.RR.T. pasi është në përputhje me ligjin.

2.Për zgjidhje konflikti i krijuar ndërmjet legatës Gjermane dhe “Studio Buza” (objekt 9 kat). Të miratohet leja e dhënë nga K.RR.T. pasi është në përputhje me ligjin.

5. Për shkresën Nr.1450, dt.07.08.2000 nga Prefektura, për rishqyrtim të vendimit të K.RR.T. Të miratohet leja e dhënë për z. Ferdinand Nallbani në Rr.”Komuna e Parisit”.
6. Kërkesa e z. Besnik Murthi Nr.prot.b-79, dt.11.08.2000 për objekt tregtar 1 kat në pronë të vet në Rr.”Mustafa Këllici”. Të miratohet refuzimi nga ana e K.RR.T. për leje ndërtimi (pra kthimin e kjoskës në ndërtim definitiv), ndërsa ndërtimi provizor të mbetet deri në zbatimin e planit rregullues për këtë zonë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI